

VENDIM
Nr.438, datë 2.7.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.43, DATË 17.1.1998 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE TË
EKSPOZITAVE TREGTARE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.43, datë 17.1.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në këto raste merret më parë miratimi i institucioneve, që kanë në varësi këto mjedise."

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Panairet dhe ekspozitat tregtare, kombëtare e ndërkombëtare të organizohen në bashkëpunim me shoqëritë e specializuara për organizim panairesh, sipas një kalendari vjetor, ku të përcaktohen lloji, koha e vendi ku ato do të zhvillohen dhe subjekti që do t'i organizojë.

Kalendari të përgatitet nga Qendra Kombëtare e Panaireve dhe të miratohet nga Ministri i Ekonomisë, brenda muajit shtator të çdo viti, për vitin pasardhës."

3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Dhomat e tregtisë dhe të industrisë, si dhe shoqatat e ndryshme të biznesit të organizojnë panaires dhe ekspozita tregtare, kombëtare e ndërkombëtare, sipas kalendarit vjetor të përgatitur nga Qendra Kombëtare Panaireve.

Panairet vendore të organizohen nën drejtimin e dhomave përkatëse të tregtisë dhe të industrisë, me mbështetjen e organeve të pushtetit vendor."

4. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Shoqëritë vendase apo të huaja, që merren me organizimin e panaireve dhe të ekspozitave tregtare, brenda muajit qershor të çdo viti të bashkëpunojnë dhe të lidhin marrëveshjet përkatëse me Qendrën Kombëtare të Panaireve për panairet dhe ekspozitat tregtare, që ato do të organizojnë për vitin paraardhës."

5. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Për të bashkërenduar veprimtaritë e panaireve dhe të ekspozitave tregtare ngarkohet Qendra Kombëtare e Panaireve, me cilësinë e personit juridik, publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, e cila është në varësi të Ministrisë së Ekonomisë. Statuti i kësaj qendre miratohet nga Ministri i Ekonomisë."

6. Pika 5 shfuqizohet.

7. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano